

GJENOCIDI DHE FORMAT E PËRMASAT E TIJ NË RRAFSHIN E DUKAGJINIT GJATË SUNDIMIT TË MBRETËRISË SERBO-KROATE-SLLOVENE (1918-1921) GENOCIDE FORMS AND DIMENSION IN DUKAGJIN AREA DURING THE KINGDOM OF SERBS-KROATIS AND SLOVENIANS (1918-1921)

ASLLAN KRASNIQI

Universiteti i Prishtinës-edukim, Universiteti "Iliria" diplomaci, "Rruga Bajram Curri" nr. 6, Klinë

Email: asllankrasniqi@hotmail.com

HYRJE

Aktet gjenocidiale dhe masakrat serbe në një pjesë të Dukagjinit me Rrethinë gjatë viteve 1918-1921, janë objekt i këtij studimi. Për të hartuar këtë studim janë shfrytëzuar burimet arkivore, kryesisht nga arkivi i Shqipërisë e Kosovës. Dokumentet u shfrytëzuan në mënyrë kritike dhe shkencore. Përpos rëndësisë shkencore, studimi ka edhe vlerën shoqërore për raportet politike aktuale. Mbështetur në këtë studim, edhe arritjet historiografike, shihet se në vazhdimësi qarqet shtetërore e politike serbe, të përkrahura nga pseudoshkenca serbe, kryen akte gjenocidiale dhe spastrim etnik të trojeve shqiptare siç është rasti me Rrafshin e Dukagjinit.

Objekti i studimit

Ngjarjet dhe studimi i kaluarës do të jenë udhërrëfyes më i mirë i gjeneratave të reja për ta njohur të kaluarën, vetveten dhe për t'i ruajtur me kujdes përpjekjet dhe frytet e së kaluarës dhe për t'i përcjellë ato te brezat që vijnë pas, nëse historia është mësuese e jetës.

Metodat (Metodologjia)

Metodat që kam përdorur në këtë studim janë të imponuara nga vet problemi i hulumtimit duke iu përmbajtur këtyre metodave: Metodave analitike dhe sintetike, historike dhe kooperative.

Fjalët çelës : Gjenocidiale, elaborate, format, Rrafshi i Dukagjinit, Mbretëria Serbo-Kroate-Sllovene, etj.

Dëshmi të Komitetit të Kosovës mbi gjenocidin dhe plaçkitjet e shqiptarëve nga serbët 1918-1921

Sipas burimeve arkivore e të shkruara, korrespondentët e Komitetit "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" me qendër në Shkodër, mblihdnin raporte

dhe të dhëna nga gjithë terreni i Kosovë. Ne po japim disa nga këto të dhëna për masakrat dhe plaçkitjet serbe në një pjesë të Rrafshit të Dukagjinit.

Sipas raporteve të këtij Komiteti, më 27 tetor 1918 serbët e pushtuan Gjakovën, zbritën flamurin shqiptar dhe të gjithë nëpunësit shqiptarë u zëvendësuan me serbë. Më 10 nëntor 1918 një patrullë serbe plaçkiti qytetin e Gjakovës. Në krahinën e Pejës anarkia shtohet nga dita në ditë. Tregu i Pejës ishte plaçkitur e popullsia nuk guxonte të lëvizte në qytet.

Më 15 nëntor në fshatin **Radavc** u bë një rrahje dhe plaçkitje e madhe. "Patrulla serbe futet në shtëpi të Vesel Bekës. Reagimi i dy djemve të Veselit për ndërhyrje barbare në familje pasoi me vrasjen e tyre. Në fshatin **Podgur** 400 shtëpi plaçkiten, bëhen bombardime pa ndërprerje. Gjendja në rrethin e Pejës ishte aq e tensionuar, saqë shqiptarët e kishin të ndaluar të takoheshin me njëri tjetrin".

Mizoritë serbe ishin nga më çnjerëzoret, të organizuara si nga qeveria në pushtet ashtu edhe nga grupet e ndryshme serbe, ndër të cilat dallohej organizata serbe "Bela Ruka" që masakronte shqiptarë.

Më 2.XII.1918 një patrullë serbe me topa e mitraloza, udhëtoui drejt fshatit **Voksh**, ata plaçkitën familjen e Ymër Tahirit, Brahim Nezirit, Isuf Kadriut, Sadik Rames, Nezir Halitit, Jahë Malës, Abdyll Pangjës, Sadri Rustemit, Ali Dibrës etj. Më 5.XII.1918 patrulla serbe në fshatin **Muzhevinë**, krahina e Pejës, hyri në shtëpi të Ymër Bekës në gjysmë të natës, e lidhën Ymër Bekën me të gjithë meshkujt dhe ia plaçkitën: të gjitha gjësendet. Pas plaçkës e largojnë nga shtëpia tërë familjen, dhe ia zaptuar shtëpinë dhe tokën. Më 6.XII.1918, në mesnatë, patrulla ka shkuar në shtëpi të Kamer Elezit në fshatin **Muzhevina** dhe e ka plaçkitur. Atë natë në këtë fshat patrulla plaçkiti shtëpinë e Daut Zekës, dhe i rrahin tërë burrat e shtëpisë. Më 8.XII.1918, patrulla serbe e sulmon shtëpinë e Ismail

Regjës në fshatin **Lubozhdë** të Pejës. I lidhën të gjithë burrat e ua plaçkitën tërë pasurinë. Më 15.XII.1918, patrulla serbe sulmoi shtëpinë e Selman Regjës, 80 vjeçar, nga i njëjti fshat. Ai së bashku me një djalosh 12 vjeçar, u mbytën dhe ua plaçkitin, kurse të mbyturit janë gjetur pas gjashtë ditësh në një shkurre. Më 16.XII.1918 një patrullë serbe në shtëpi të Adem Ymerit në fshatin **Lubeniq** të Pejës, i lidhin dhe i rrahin të gjithë burrat e shtëpisë dhe ua plaçkitin mallin. Po të atë ditë plaçkitën shtëpitë e Mehmet Alisë e Tafë Zymerit nga fshati **Muzhevena**, u plaçkitë gjithë pasurinë e shtëpive dhe u rrahën burrat. Po këtë ditë e në të njëjtin fshat plaçkiten shtëpitë e Ukë Musës dhe Murat Bajramit. Më 17.XII.1918, në mesnatë, patrulla serbe e sulmon shtëpinë e Daut Hysenit në fshatin **Llukavc**, i lidhin të gjithë burrat e shtëpisë dhe e plaçkitin. Atë natë u plaçkitën shtëpitë e Rexhep Nekës, Ibish Muslisë dhe Shaban Rrustemit. Më 18.XII.1918 patrulla serbe, prej afro 200 vetave, sulmon shtëpinë e Bajram Metës e Nezir Salihut në fshatin **Rudicë** të Pejës, me ç'rast marrin Bajramin me vëlla Aliun dhe të birin Ukën, kurse burrat e tjerë i dërgojnë në pyll i rrahin, kurse Ukën e pushkatojnë. Më 20.XII.1918 rinia shqiptare e rrethit të **Junikut**, nga mizoritë serbe, u mbloodh në një pyll afër Junikut. Të njëjtën ditë 700 ushtarë serbë me topa e mitraloz filluan t'i gjuajnë shtëpitë e Junikut me ç'rast u vranë 12 veta. Atë ditë ushtria hyri në Junik, shtëpia e Salih Bajraktarit (i cili ishte kryetar i Junikut) u plaçkitë. Pastaj i plaçkitën shtëpitë e Arif Bajramit, Haxhi Ahmetit, Zeqir Ahmetit, Sadri Musës, Osman Beqës, Beqir Tafës, Nezir Sylës, Haxhi Zymerit, Mehmet Idrizit etj. Më 21.XII.1918 serbët, pasi i kishin burgosur më parë katër persona nga fshati **Mertuur**, i nxjerrin nga burgu, i pushkatojnë dhe i lënë të vdekur afër qytetit të Gjakovës. Më 22.XII.1918 patrulla serbe, kapë Kolë Çetën dhe Lazër Çetën në **Gjakovë**, i ka burgosur. Më 22 dhjetor arrestohet Jonuz Halili nga **Temoci (Tomoci)**. Ai vritet në fshatin Llukavc. Të njëjtën ditë vritet edhe Ali Shabani nga fshati **Vrellë** i Pejës, kufoma e të cilit gjendet dhjetë ditë pas vrasjes. Më 23.XII.1918 patrulla serbe e sulmon shtëpinë e Bajram Ramës, bajraktarit të **Strelcit** të Pejës, të cilit ia djegin tërë pasurinë. Më 28.XII.1918 patrulla serbe theu depon Mehmet Ali Rudit në **Gjakovë**, ia plaçkisnin tërë mallin. Më 31.XII.1918 patrulla serbe sulmon shtëpinë e Sejdi Hulës nga fshati **Voksh**, të cilin e lidhin së bashku me dy djemtë. Në momentin kur po përgatiteshin t'i pushkatonin, njëri djalë, Ramadani, i ka zgjidhur duart dhe i ka marrë pushkën një ushtari, duke e vrarë një tjetër. Pas dëgjimit të krismës u ngrit më këmbë fshati, dhe patrulla u detyrua të ikte. Më 2.I.1919, 200 ushtarë serbë me 6 topa e me 24 mitraloza shkuan në këtë fshat dhe plaçkitën fshatin.

Më 3.I.1919 është mbytur nga serbët në **Pejë**, nip i Xhemë Sylejmanit. Më 4.I.1919 serbët në fshatin **Llozhan** të Pejës kanë mbytur Ali Hasanin dhe Ibrahim Rexhepin, Më 5.I.1919 patrulla serbe hyri në shtëpi të Ibrahim Kamberit në fshatin **Strellc**, të cilin e kanë vrarë në oborr të vet. Atë ditë patrulla serbe e vrau edhe Arif Zymerin nga fshati **Isnig**.

Të dhëna të shumta flasin për mizoritë e ushtrisë serbe në Pejë dhe Gjakovë nga data 8.I.1919 deri më 26.I.1919: Patrulla serbe në shtëpinë e Ramë Ibishit nga fshati **Llukavc** i lidhin të gjithë burrat dhe plaçkitin mallin e shtëpisë. Në fshatin **Lubeniq** të Pejës në rrugë mbysin Sadri Bushatin dhe me një shok të tij. Në fshatin **Berku** të Pejës mbysin Tahir Bedrën nga fshati Strellc i Pejës. Natën sulmohet edhe shtëpia e Ali Muslisë nga fshati **Ramoc**, të cilin e kanë mbytur. Bardhosh Rama dhe Isuf Zeka nga fshati **Strellc** duke u kthyer nga Peja rrahën nga patrullën serbe, atyre iu morën edhe 650 korona. Policia serbe e sulmon në mesnatë shtëpinë e Mahmut Demës në fshatin **Brigada** të Pejës, të cilin të lidhur e therin me bajoneta. Pasi e mbysin Mahmutin, ia marrin edhe djalin 18 vjeçar, vajzën 15 vjeçare dhe gruan, të cilët i mbysin me bajoneta në oborr të shtëpisë. Nga kjo familje ka shpëtuar vetëm një djalë i vogël, i cili kur ndodhi krimi kishte qenë te dajat e vet. Në fshatin **Tomoc** të Pejës patrulla serbe e merr në shtëpi të vet Shaban Lubeniqin, të cilin në pyll e vret. Në fshatin **Llukavc** patrulla serbe merr Sadri Zekën, Niman Nimanin dhe Sali Ferizin, të cilët i dërgojnë te disa shkurre dhe i kanë mbytur. Po kjo patrullë serbe sulmon shtëpinë e Ukë Jahës nga fshati **Muzhevinë**, në mesnatë, ku, pasi arrestojnë Ukën me të vëllanë, i lidhin në një pyll larg shtëpisë dhe i mbysin duke i ther me bajoneta. Në këtë fshat arrestohet Dem Rugova me të vëllanë, të cilët i mbysin në pyll dhe i lanë në shkurre. Në fshatin **Tomoc** merret në mesnatë Tahir Selmani, të cilin e mbysin. Në fshatin **Dragolevc** patrulla e sulmon shtëpinë e Ali Zeqirit me ç'rast ia marrin djalin e tij dhe Aliun e dërgojnë në pyll dhe e mbysin. Po në këtë fshat, Sejdi Çakut i arrestohen tre djem, të cilët natën i mbysin në një shkurre duke i mbuluar me dushk.

Sipas raporteve të Beqir Vokshit nga dega e "Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës" në Gjakovë njoftohet se "serbët i kanë mbytur 16 persona në krahinë të **Pejës**, të cilëve nuk u dihen emrat, sepse në këto krahina, sidomos nga lugu i **Drinit** dhe **Podguri**, nuk ishte e mundur të dilte nga shtëpia asnjë shqiptar për t'i treguar emrat e të mbyturve. Për shkak të mizorive të mëdha edhe ata njerëz që ishin në shtëpi nuk mundnin të largohen nga shtëpia as për në mulli. Shpeshherë ka ndodhur që njerëzit në këto krahina me nga dhjetë ditë janë ushqyer me misër të zier. Shumë

familje i kishin lëshuar shtëpitë dhe tokën dhe kishin shkuar në anë të Gjakovës për shkak të mizorive serbe. Serbët e kanë dërguar një patrullë në përbërje prej 15 vetash në lug të Drinit, dhe i kanë detyruar fshatarët që t'u japin nga 3000 korona pagë mujore, gjithashtu t'u japin me dhunë xhandarmërisë serbe drekë dhe darkë”.

Serbët, pasi i kanë burgosur Hasan Bajraktarin, Idriz Fekën, Shaban Haxhiun e Sadik Ramën nga fshati **Radavc** i mbajnë të burgosur dy muaj pa asnjë arsye, i liruan me të holla. Kjo ishte një formë e grabitjes dhe njerëzit burgoseshin pa asnjë arsye. Në fshatin **Tomoc** një të premtë me të dalë nga xhamia patrulla serbe i gjuan shqiptarët me ç'rast plagoset djali i Selman Shabanit. Serbët kishin filluar të grumbullonin misrin nga populli në krahinën e Pejës e Gjakovës. Në masat popullore vërehej frikë e madhe për mungesën e bukës. Beqir Vokshi, këto dëshmi, ia ka dërguar Kryesisë qendrore KMKK në Shkodër, ku potencon se në muajin janar numri i mizorive ka qenë aq i madh, saqë nuk ka pasur mundësi të evidencohen as 1/3 e tyre. Dega e Komitetit të Kosovës në Gjakovë, dëshmon edhe për disa vrasje të fëmijëve gjatë janarit 1919, si vrasja e vajzës dhjetëvjeçare të Metë Ibrahimit nga fshati **Buzëthatë**, vrasja me bajonetë e një bariu tetëvjeçar nga fshati **Leçinë** e Istogut, vrasja në fshatin **Kovragë** e dy djemve të Selim Mehmetit nga fshati **Bellopojë**, vrasja e djemve të Bekë Zymerit, njëri tetë e tjetri dymbëdhjetëvjeçar etj. “Në **Gjakovë** më se 800 persona u vranë barbarisht, iu plaçkitën shtëpitë dhe bagëtia. Nga familjet u morën 46 vajza, nga të cilat 6 u dhunuan, kurse të tjerat për të pësuar të njëjtin fat u dërguan në Mal të Zi”. Në fshatin **Koshutan** Abdyl Hazirit ia kanë vrarë 3 barinjët, Zymer Smajlin e kanë vrarë dhe djegur shtëpinë, pastaj e vranë Sali Aliun bashkë me Tomë Ramën, derisa ktheheshin nga Peja në fshat. Bajram Rrustemin, pasi e plaçkitën, e kanë vrarë. Në të njëjtën mënyrë u vra edhe Regjë Haxhiu. Në fshatin **Kuqishtë** u vra dhe u plaçkit Xhixhë Sokoli. Në fshatin **Bukel** u vra Mursel Salihu, Abedin Baxhuji dhe Halil Zeqa, dhe iu plaçkitën pasuritë që kishin. Në fshatin **Bisirnicë** u vranë Mehmet Ismajlin, Ibish Bajramin dhe tre barinj që ishin duke ruajtur delet. Në fshatin **Pepiç** i dhunojnë shumë femra shqiptare. Fshatarët plaçkiten dhe vritet një djalë i ri.

Konfiskimi i pasurisë dhe mizoritë i dëshpërojnë bajraktarët e krahinës së Rugovës, ata kërkojnë një takim me komandën e Pejës. Në Poklen, te Guri i Biruam, hapet zjarr kundër bajraktarëve, dhe ata detyrohen të mbrojnë jetën e tyre. Në këtë mënyrë filloi lufta e Rugovës me hapjen e zjarrit nga forcat serbe. Komiteti i Kosovës i ka paraqitur Lidhjes së Kombeve në Gjenevë shënimet se gjatë janarit dhe

shkurtit të vitit 1919 në rajonin e Dukagjinit ishin bërë këto mizori.

Krimet e okupatorit serb më 1918-1921

Rrethet	Të vrarë	Të burgosur	Të rrahur	Shtëpi të djegura	Shtëpi të plaçkitura
Pejë	1.560	3.800	240	714	1.970
Prizren	836	2.700	120	770	1562
Gjakovë	68	200	25	56	78
Gjithsej	2464	6700	385	1540	3610

Të dhënat jepen vetëm për tri rrethet më të mëdha në Dukagjin, pa rrethet më të vogla. Fshatrat shqiptare, dikur të lulëzuara, u bënë hi dhe shkumb prej agresorëve serbë, të porositur nga Beogradi gjakatar. se 900 shtëpi janë djegur dhe 12.000 krerë bagëti janë plaçkitur. Duhet theksuar se për shkak të plaçkitjeve dhe mizorive nuk kishte shqiptarë në Dukagjin, i cili mund të flinte i qetë ndonjë natë nga frika prej serbëve, të cilët i sulmonin natën shtëpitë e shqiptarëve.

Rezultatet (konkluzionet)

Bazuar në aktet gjenocidiale në Rrafshin e Dukagjinit, sipas dokumenteve arkivore dhe literaturës, mund të behën disa përfundime: Ndërmjet dy luftërave botërore Mbretëria e Jugosllave hartoi projekte dhe akte të ndryshme antishqiptare-gjenocidiale. Për të arritur këtë qeveria jugosllave bëri masakra të papara mbi fëmijë, gra e pleq që nuk kishin bërë asnjë rezistencë. U bënë edhe plaçkitje e djegie në fshatra të tëra. Kjo dëshmon se qarqet serbe në vazhdimësi sundonin me gjak, viktime e tyre ishin shqiptarët. Rezistenca shqiptare e mbajti gjallë popullin shqiptar dhe u bë pengesë për realizimin e planeve shfarosëse serbe. Lufta e shqiptarëve për liri ishte e rëndë, por populli shqiptar kishte besim në triumfin e së drejtës. E drejta ishte me ta dhe herët a vonë do ta fitonin lirinë.

BURIMET DHE LITERATURA

Burime arkivore të pabotuara

1. Arkivi Qendror i Shqipërisë,-fondi, 846,dosja 35, fl. 2, 5, 9, 18, 19, 21, 23, 26, 29. 35; 35/1.

Literatura historike

2. Abdyl, Ramiz. *Shpronësimi i fshatarësisë dhe kolonizimi serbo-malazez i trojeve etnike shqiptare 1912-1941*; “Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të pushtetit serb ndaj shqiptarëve nga Kriza lindore e këndejt”, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1995,

3. Bajrami, Hakif. *Politika e shfarosjes së shqiptarëve dhe kolonizimi serb i Kosovës (1844-1995)*. Prishtinë, 1995,
4. Bajrami, Hakif. *Shpërngulja e shqiptarëve në Turqi gjatë viteve 1912-1941*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës. Prishtinë, 1995,
5. Gruda Zejnulla, *Nocioni i gjenocidit sipas dokumenteve ndërkombëtare*, "Gjenocidi dhe aktet gjenocidiale të popullit serb ndaj shqiptarëve nga kriza lindore e këndejt", Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1995,
6. Gotard Justin, *Albanien 1921, Paris, 1922*,
7. Nushi Pajazit, *Determinantët psikosociale të gjenocidit të pushtetit serb ndaj shqiptarëve dhe struktura kognitive e tyre*, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, Prishtinë, 1995,
8. Rushiti, Liman. *Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928)*. Prishtinë, 1981.